

AKT STATUTI-AKT THEMELIMI

NENI-EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Shoqeria Tregtare me pergjegjesi te kufizuar TIRANA THROWDOWN SHPK”e cila ketu me poshte do te quhet Shoqeria,ajo krijohet nga dy ortakete themelues:

- 1. Z.Ergys Male** i datelindjes **26.08.1995** lindur ne **Tirane** dhe banues ne **Tirane** i identifikuar nga karta e identitetit me **Nr:J50826063E**.
- 2. Z.Erion Maksuti**,i datelindjes **25.02.1990** lindur ne **Erseke** e banues ne **Tirane**,i identifikuar nga karta e identitetit me **Nr J00225065P**.

1.1. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjëgjesi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

1.2. Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

Neni 2- FORMA

Forma ligjore:**Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar**.

NENI 3 - BAZA JURIDIKE

Shoqeria krijohet ne baze te legjislacionit te Republikes se Shqiperise dhe si person juridik,e zhvillon aktivitetin ne perputhje me kete legjislacion dhe me normat e ketij statuti.Ajo e fiton personalitetin juridik pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 4- SELIA

Selia e shoqerise do te jete ne Rruga : **Tirane,Rruga Papa Kristo Negovani,pallati Moxart,shk2 ap.19,Tirane**,dhe mund te ndryshoje adresen e selise se saje vetem me vendim te asamblese se ortakëve.

NENI 5- TERRITORI

Shoqeria e zhvillon aktivitetin ne territorin e Repulikes se Shqiperise dhe jashte saje.

Shoqeria mund te krijojë dege(filiale)ose perfaqesi,ne rrethe te ndryshme te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne shtete te tjera,ne perputhje me legjislacionin e vendeve perkatese

NENI 6-OBJEKTI VEPRIMTARISE

Objekti veprimtarise se shoqerise do jete :**EVENT SPORTIV**

Per kryerjen e aktivitetit te shoqerise se mesiperme,per te cilin do te nevojitet leje perkatese,shoqeria eshte e detyruar te paiset paraprakisht nga organet kopetente.

NENI 7- KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe pa afat.

NENI 8- FUSHA E AUTORITETIT TE ORTAKUT

Fusha e autoritetit te ortakut dhe perqindja e fitimive ose humbjeve do te kene si kriter baze kapitalin e Shoqerise si edhe kompetencat qe gjejne ortaket me marrjen e vendimeve te cdo karakteri,te percaktuara ne kete statut.

NENI 10- KONFIDENCIALITETI

Ortakët ose Asambleja e Ortakeve si edhe personat e tjere te pranuar prej tije/tyre ne Shoqeri bieh dakort qe te mos i ekspozojne asnje personi te jashtem informacionet qe disponon Shoqeria,kontratat qe ajo do te lidhe,cdo lloj materiali si edhe planet ose qellimet qe ajo ka per te ardhmen e saj.


NENI11-DOKUMENTET E DESTINUARA PER TE TRETET

Te gjitha aktet dhe dokumentet qe nxirren nga shoqeria dhe jane te destinuara per te tretet ,si letrat,faturat,lajmerimet,publikimet e ndryshme etj,duhet te tregojne lexueshem emriin e shoqerise dhe pas tij fjalet "Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose inicialet "SHPK" si edhe te jepet pelqimi dhe miratimi nga te dy administratoret e shoqerise te zgjedhur nga secili ortak.Te gjitha aktet e shoqerise,ato me te trete,si edhe cdo veprim qe do te kryhet ne emer e per llogari te shoqerise duhet te behet me miratim te dyanshem,te njekohshem nga te dy administratoret e saj,ne rast te kundert secili administrator do te mbaje pergjegjesi ligjore e personale per demin e shkaktuar ndaj shoqerise dhe do ta demshperbleje ate ne vleren perkatese.

NENI 12- KAPITALI THEMELTAR

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke(Njeqindmije leke).Ky kapital eshte tersisht i nenshkruar dhe i shlyer nga ortaket.Shoqeria mund te shtoje ose te zvogeloje kapitalin,ne varesi te nevojave dhe rezultateve te saj,sipas vendimit te asamblese se ortakeve.

NENI 13- KONTRIBUTET



Kapitali themeltar i shoqerise eshte i perbere nga kontributi i ortakeve te shoqerise Z.Ergys Male dhe Z.Erion Maksuti, me pjesemarrje te barabarte secili ne masen 50%(pesedhjete perqind) ne vleren prej 100 000 leke (Njeqind mije leke).

NENI 14- PJESET E KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali themeltar eshte i perbere prej 2(dy)kuotave, plotesisht te shlyera, me vlere nominale te seciles kuote 50 000 leke (pesedhjete mije leke).

NENI 15-LENIA DHE TRANSFERIMI I PJESEVE TE KAPITALIT

Kapitali themeltar eshte lirisht i transferueshem tek personat e trete, ne qofte se Asambleja e ortakeve vendos per kete. Ai mund te lihet peng sipas legjislacionit ne fuqi.

Gjithashtu kapitali themeltar eshte i transferueshem ne rruge trashegimie ku bashkeshortja/i paraardhesit dhe pasardhesit mund te behen ortake nepermjet transferimit te pjeseve te kapitalit themeltar, me vendim te asamblese se ortakeve dhe sipas kushteve qe lejohen me ligje.

Transferimet e pjeseve te kapitalit themeltar duhet te vertetohen me nje akt noterial ku do te nenshkruajne te gjithë ortaket e shoqerise apo perfaqesuesit e tyre. Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte drejtues dhe ushtron te gjitha kompetencat qe njihen me ligj per shkak te kesaj cilesie.

NENI 17-KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

-Vendos per ndryshimet ne Statutin e Shoqerise dhe perpilon , miraton rregulloret per Shoqerine apo sektore te vecante te veprimtarise.

-Vendos per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit dhe transferimin e pjeseve te kapitalit.


-Vendos per politiken afariste te Shoqerise dhe detajon kompetencat e tyre te percaktuara ne statut dhe sipas rastit Ekspertin Kontabel.

-Shqyrton bilancin vjetor ,percakton llojet e fondeve te ndryshme dhe masen e tyre, fitimin e realizuar si edhe vendos per marrjen e kredive.

-Vendos per krijim e degeve (filialeve) ose te perfaqesive si edhe per krijimin e shoqerive me persona te tjere fizik apo juridik.

-Vendos per mardheniet e rendesishme ekonomike dhe financiare te shoqerise me persona te tjere fizik apo juridike, vendas apo te huaj.

-Vendos per mbarimin e shoqerise ,likuidimin e saj si edhe shnderrimin e shoqerise nga shoqeri me prgjegjesi te kufizuar ne shoqeri te formave te tjera ligjore.



-Vendos me cmimin e mallrave/sherbimeve

-Vendos per pagat e punonjesve ne shoqeri.

NENI 18-ADMINISTRATORI DHE KOMPETENCAT E TIJE

Ortaket kane vendosur qe shoqeria do te kete 1 administrator te emeruar nga asambleja e ortakeve. Kompetencat e administratorit ne menyre konkrete dhe te detajuar percaktohen ne aktin e emerimit. Vec te tjerave qe mund te detajohen ne kete akt, administratori ka keto kompetenca :

-Realizojne administrimin, drejtimin dhe perfaqesimin e Shoqerise ne mardheniet me persona te tjere juridike apo fizike.

-Kujdeset per funksionimin e perditshem normal te shoqerise ose te nje pjese te aktivitetit ekonomik dhe financiar te saj, sipas percaktimit ne aktin e emerimit .

-Pergatit dokumentacionin dhe raportet e ndryshme per gjendjen ekonomike dhe financiare te Shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ia paraqesin Ortakeve per shqyrtim.

-Koordinon veprimtarine e personave te punesuar ne Shoqeri.

-Shqyrtojn ofertat dhe pergatit kerkesat te cilat ua paraqet ortakeve per miratim.

-Ndjek problemet e Shoqerise ne mardhenie me organet shteterore ose cakton ndonje prej personelit per trajtimin e ketyre problemeve.

-I propozon ortakeve te Shoqerise cmimet e mallrave si edhe pagat per personelin e punesuar ne Shoqeri.


-I propozon ortakeve rregulloret per sektoret e vecante te Shoqerise.

Administratori eshte pergjegjes ndaj shoqerise ose ndaj te treteve si per shkelje ligjore ashtu edhe per shkelje te statutit ose per faje te kryera gjate administrimit te tij.

Kompetencat e administratorit jane te pakufizuara

Neni-19LIBRAT E SHOQERISE

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje pervec Librit te Shoqerise ,ne te cilin shenohet emri i plote i ortakeve,kapitali themeltar,si edhe vendimet e ortakeve ,dokumentacionin kontabel dhe libra te tjere.



NENI 20- BILANCI

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabel miratohen nga asambleja e ortakeve.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 21- DIVIDENTET

Ortakët asambleja e ortakeve miraton llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit. Përcakton fitimin e vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lena menjëherë për rezervën sipas ligjit ose të përcaktuar nga vete ortakët/asambleja e ortakeve, fondet e tjera që shihen të nevojshme dhe nga na tjetër i janë zbritur ose i janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme, kështu ortakët /asambleja e ortakeve përcakton dividendin.

NENI 22- MBARIMI

Shoqëria mbaron me vendim të asamblese së ortakeve ose kur ka prishje të parakohshme për arsye të parashikuara në ligj.

NENI 23- LIKUJDIMI

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi asambleja e ortakeve cakton një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitetit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatin e nevojshëm të perfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit asambleja e ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Mbas pagimit të kreditorëve asambleja e ortakeve mban pjesën e mbetur të kapitalit.


NENI 24- ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE

Të gjitha mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së Shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do t'i paraqiten për zgjidhje Gjykatës Kompetente Shqiptare.

NENI 25

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë. Shoqëria do të ketë vulën e sajë, formën dhe madhësinë e së cilës do të përcaktohet nga ortakët.

1-Administratori i Shoqërisë është:



Z. Ergys Male i biri i Gezimit dhe Aslianës i datelindjes 26.08.1995 lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane i identifikuar nga karta e identitetit me Nr:J50826063E.

NENI 26-MBYLLJA E SHOQERISE

Veprimtaria e shoqërisë mund te ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjate dy vjetëve te fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 27-LIKUIDIMI

27.1 Menjëherë pas marrjes se vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit te shoqërisë, me dispozitat përkatëse te ligjit tregtar. Shoqëria gjate likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri ne Likuidim e siper".

27.2 Likuiditori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar te publikoje bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vene ne dispozicion menjëherë ortakeve.

27.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 28

Ortakët vendosin mbi rregulshmerine e likuidimit, per te vendosur per bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit te likuiditorit.

Ortakët mund te vendosin vete realizimin e kesaj mbledhje, ne rast se likuiditori nuk e kerkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose te nje mandatmbajtësi te caktuar prej tij.

NENI 29

Kur ortakët për shkaqe te arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund te kërkoje nga Gjykata mbylljen e likuidimit.


Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit te dokumentacionit ne regjistrin tregtar Shoqeriac regjistrohet prej tij.

NENI 30- Dispozitat e fundit

30.1 Për te gjitha ceshtjet qe nuk gjejnë rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtarete dhe Shoqerite Tregtare"

30.2 Per efekt te inteprentimit te ketij Statuti me Ligj Tregtar nenkuptohet Ligji nr 9901 date 14.04.2008 "Per Shoqerite Tregtare"

30.3 Pavlefshmëria eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojnë vlefshmërinë e tij.



NENI 31-Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimin e Statutit te Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 32- HYRJA NE FUQI

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

" TIRANA THROWDOWN " sh.p.k.

ERGYS MALE

Ergys Male


ERION MAKSUTI

Erion Maksuti
